



Australian Government

# Shtetësia australiane

## Lidhja jonë unike

Gjithë informacioni që ju nevojitet për provimin e shtetësisë australiane gjendet në këtë libër. Në mënyrë që të kaloni provimin e shtetësisë nuk ju duhet të bleni apo të merrni nga individë apo organizata materiale të tjera. Departamenti nuk miraton apo rekomandon asnjë material që pretendon t'ju ndihmojë për të kaluar provimin e shtetësisë.

© Commonwealth of Australia 2020

Me përjashtim të stemës së Komonuelthit, i gjithë materiali i paraqitur në këtë botim është subjekt i licencës ndërkombëtare 4.0 të Creative Commons Attribution në <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/legalcode>.

Kjo nënkupton që kjo licencë zbatohet vetëm për materialin siç përcaktohet në këtë dokument.



Detajet e kushteve të licencës përkatëse disponohen në portalin Creative Commons në adresën <https://creativecommons.org/>, sikurse disponohet edhe kuadri i plotë ligjor i licencës CC BY 4.0 në <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/legalcode>.

#### **Përdorimi i stemës**

Kushtet sipas të cilave mund të përdoret stema jepen të detajuara në faqen zyrtare të Departamentit të Kryeministrit dhe Kabinetit të tij – <https://www.pmc.gov.au/government/commonwealth-coat-arms>.

#### **Na kontaktoni**

Pyetjet lidhur me licencën dhe çdo përdorim të këtij dokumenti janë të mirëpritura në:

Degën e mediave dhe angazhimit të portofolit

Departamenti i Punëve të Brendshme

PO Box 25

BELCONNEN ACT 2616

#### **Përgjegjësia**

Lexuesit aborigjenë dhe njerëzit nga Ishulli Torres States paralajmërohen që ky botim përmban pamje dhe/ose flet për njerëz që kanë ndërruar jetë.

# Përmbajtja

|                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------|----|
| Një mesazh për ju                                              | 2  |
| Pjesa për të cilën do pyeteni                                  |    |
| Pjesa 1: Australia dhe populli i saj                           | 7  |
| Pjesa 2: Vlerat demokratike, të drejtat dhe liritë në Australi | 17 |
| Pjesa 3: Qeveria dhe ligji në Australi                         | 23 |
| Pjesa 4: Vlerat australiane                                    | 33 |
| Fjalor i pjesës që do pyeteni                                  | 40 |
| Pjesa për të cilën nuk do pyeteni                              |    |
| Pjesa 5: Australia në ditët e sotme                            | 48 |
| Pjesa 6: Historia jonë australiane                             | 63 |
| Fjalor i pjesës për të cilën nuk do pyeteni                    | 84 |
| Për më shumë informacion                                       | 86 |
| Falënderime                                                    | 88 |



# Një mesazh për ju

Përgëzime që keni vendosur të bëheni shtetas australian. Duhet kurajë, përpjekje dhe përkushtim për të jetuar në një shtet tjetër por edhe për të marrë pjesë plotësisht në jetën e atij vendi si shtetas i tij. Ne e vlerësojmë kontributin tuaj në shoqërinë tonë paqësore dhe demokratike.

Marrja e shtetësisë australiane është një hap i rëndësishëm në historinë tuaj të emigrimit. Të bëhesh shtetas australian do të thotë që ju po merrni përsipër një premtim afatgjatë ndaj Australisë dhe vlerave të saj. Në të njëjtën kohë, është dhe fillimi i të qenurit zyrtarisht, pjesëtar i komunitetit australian. Është hapi që do t'ju krijojë mundësinë që ju të thoni 'Unë jam australian'.

Shtetësia australiane është një nder i madh që ofron shumë shpërblime. Duke u bërë shtetas australian, ju bëheni pjesëtar i një kombi të veçantë. Vendi ynë është ndërtuar në bazë të kontributit të popullit aborigjen dhe të ishujve Torres Strait, të institucioneve demokratike të trashëguara nga Britania dhe emigrantët nga mbarë bota.

Ne festojmë diversitetin tonë dhe në të njëjtën kohë, përqijemi që të jemi një vend i bashkuar dhe që jeton në harmoni.

Fuqia e shoqërisë australiane qëndron në faktin që ne punojmë të gjithë së bashku për të zgjidhur problemet tona dhe në këtë mënyrë ta bëjmë Australianë ashtu siç edhe është, një vend të mrekullueshëm. Ne kemi një sistem të qëndrueshëm qeverisës dhe australianët respektojnë autoritetin dhe ligjet e qeverisë. Stabiliteti, kultura dhe ligjet tona janë rregulluar nga historia jonë. Duke u bërë pjesëtarë i komunitetit australian ju do të trashëgoni këtë histori si dhe do të jeni në një pozitë që do të kontribuoni në të gjithashtu.

Australia është tokë e lashtë. Është e madhe dhe e veçantë. Është një vend tropikal dhe pyjor; me plazhe të arta dhe shkretëtira të thata. Kultura vendase është një ndër kulturat në vazhdim më të vjetra në botë. Në të njëjtën kohë ne jemi një komb i ri; një komb me emigrantë. Ardhja e parë e evropianëve në Australi, e ka fillimin në vitin 1788 dhe që atëherë e deri në ditët e sotme, ne vazhdojmë të mirëpresim emigrantë të rinj.

Njerëz nga më shumë se 200 vende të tjera, e kanë bërë Australinë shtëpi të tyre. Për këtë arsye, Australia është një nga vendet me të larmishme në tërë botën. Në mënyrë të suksesshme, Australia kombinon larminë kulturore dhe etnike në një bashkim kombëtar. Shtetësia është lidhja që na bashkon ne të gjithëve.

Australia është demokraci. Shtetësia ju jep mundësinë të merrni pjesë plotësisht në ndërtimin e kombit tonë demokratik. Do të thotë, që jeni gati për të përmbushur detyrimet tuaja si një pjesëtar zyrtar i komunitetit australian. Australianët besojnë në vlerat e përbashkëta, si dinjiteti dhe liritë e çdo personi, barazia mes meshkujve e femrave dhe në rendin ligjor. Shtetësia australiane do të thotë të jetosh me këto vlera në jetën e përditshme.



# Marrja e shtetësisë australiane

Marrja e shtetësisë australiane është një proces i rëndësishëm gjatë të cilit personi zotohet për besnikërinë e tij ndaj Australisë dhe popullit të saj, dhe më pas ka të drejtë të ushtrojë të drejtat dhe përgjegjësitë si qytetar i kombit tonë.

## Provimi i shtetësisë australiane

Provimi për të marrë shtetësinë australiane është i formuluar në një mënyrë të tillë për të vlerësuar nëse keni apo jo njohuri të mjaftueshme për Australianë, të drejtat dhe përgjegjësitë e shtetësisë.

Provimi i shtetësisë është një test i shumëllojshëm (ku nga shumë zgjidhje do të zgjidhet ajo që është korrekt) në gjuhën angleze dhe jepet me kompjuter. Procesi konsiston në 20 pyetje të zgjedhura në mënyrë rastësore dhe që prej datës 15 nëntor 2020 do të përfshijë gjithashtu pesë pyetje mbi vlerat australiane.

Për të kaluar provimin, ju duhet t'i përgjigjeni saktë të pestë pyetjeve mbi vlerat, me një vlerësim total prej të paktën 75 për qind.

Provimet për shtetësinë, mbahen pranë zyrave të Departamentit të Emigracionit dhe Shtetësisë rreth e qark Australisë. Provimet mbahen gjithashtu në një numër të caktuar zonash rajonale apo zyra diplomatike jashtë Australisë.

## Si të përgatitesh për provimin e shtetësisë australiane

Që të përgatiteni për provimin e shtetësisë, ju nevojitet të lexoni këtë libër me informacione, *Shtetësia australiane: Lidhja jonë unike*.

Ky libër informacioni ka në përbërje pjesën për të cilën ju do pyeteni dhe atë që ju nuk do të pyeteni.

### Pjesa për të cilën do të pyeteni

Gjithë informacioni që ju nevojitet për t'ju përgjigjur dhe për të kaluar provimin, gjendet në tre pjesët e para të këtij libri:

- Pjesa 1 – Australia dhe populli i saj
- Pjesa 2 – Vlerat demokratike, të drejtat dhe liritë në Australi
- Pjesa 3 – Qeveria dhe ligji në Australi
- Pjesa 4 – Vlerat australiane

Ju duhet të dini dhe të kuptoni mirë informacionin në pjesën e librit që ka të bëjë me pyetjet për të cilat ju do pyeteni, në mënyrë që t'ju përgjigjeni atyre.

### Pjesa për të cilën nuk do pyeteni

Pjesa e librit që ka të bëjë me informacion për të cilin ju nuk do të pyeteni, ka të dhëna të rëndësishme që do t'ju ndihmojnë të kuptoni historinë dhe kulturën e Australisë. Ju nuk do të pyeteni për këto informacione.

- Pjesa 5 – Australia në ditët e sotme
- Pjesa 6 – Historia jonë australiane

### Pyetje me përgjigje

Në fund të pjesës për të cilën ju do pyeteni, do të gjeni 20 pyetje me përgjigjet përkatëse, të cilat do t'ju ndihmojnë për t'u përgatitur për provimin e shtetësisë.

### Fjalorë

Si në fund të pjesës që ju do pyeteni ashtu edhe të asaj që nuk do pyeteni do të gjeni një fjalor (lista e fjalëve kyçe dhe kuptimet përkatëse).

### Më shumë informacion

Në pjesën e pasme të librit të burimit mund të gjeni këshilla mbi ku mund të gjendet më shumë informacion.

## Ndihmë që mund të jepet gjatë provimit të shtetësisë australiane

Pritet që shumica e shtetasve australianë të ardhshëm të jenë të aftë të përballojnë provimin e shtetësisë pa qenë nevoja për të kërkuar ndihmë. Gjithashtu disponohet teknologjia e konvertimit të tekstit në bisedë që mund të përdorni për të dëgjuar pyetje dhe zgjedhjet e përgjigjeve.

## Pas provimit të shtetësisë australiane

Nëse kaloni testimin, ne do të vijojmë me vlerësimin e aplikimit tuaj. Nëse aplikimi juaj miratohet dhe ju kërkohet të merrni pjesë në ceremoninë e shtetësisë, do të merrni një ftesë për këtë. Përgjithësisht ceremonia mbahet gjashtë muaj pas datës së miratimit të aplikimit tuaj.

# Betimi i shtetësisë australiane

Është e rëndësishme për gjithë shtetasit australianë, si për ata të lindur këtu edhe për ata që janë bërë shtetas me dëshirë, të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë tona, si dhe çdo të thotë të jesh shtetas. Ky hap është kritik për vijimësinë e suksesit të kombit tonë.

Si pjesëmarrës në ceremoninë e marrjes së shtetësisë australiane, ju do të bëni betimin e shtetësisë australiane.

Në këtë mënyrë, ju merrni një zotim të hapur ndaj Australisë dhe pranoni përgjegjësitë dhe privilegjet e shtetësisë.

Ky është betimi që ju do të bëni:

***Që nga kjo kohë e më pas, përpara Zotit,\****  
***Ofroj besnikërinë time ndaj Australisë dhe popullit të saj***  
***në vlerat demokratike të të cilëve unë besoj,***  
***liritë dhe të drejtat e të cilëve unë i respektoj, dhe***  
***ligjeve të së cilëve unë do t'u përmbahem dhe zbatoj.***

\* Personi mund të zgjedhë nëse do apo jo që të përdorë fjalën "përpara Zotit".

Si ta lexoni këtë libër, ju do të krijoni një imazh të plotë për kuptimin e plotë të betimit dhe se si mund të zgjeroni rolin tuaj në shoqërinë australiane.



## Ceremonia gjatë marrjes së shtetësisë australiane

Ceremonitë që mbahen gjatë marrjes së shtetësisë australiane mund të jenë të vogla, me një numër të vogël të ftuarish, ose mund të jenë të mëdha ku numri i të ftuarve mund të arrijë në qindra ose edhe mijëra. Emocionet e thella dhe krenaria midis qytetarëve të rinj dhe zyrtarëve, e kthejnë ceremoninë në një festë shumë gazmore.

Në fillim të ceremonisë së shtetësisë, mund t'ju urohet mirëseardhja nga një përfaqësues i indigjenëve vendas të cilët janë pronarët tradicional të tokës në zonën tuaj. Ky protokoll i 'Mirëseardhjes në vend' është praktikuar nga australianët indigjenë në vendet e tyre të origjinës për mijëra vite. Ju do të dëgjoni gjithashtu fjalë inkurajuese dhe urime mirëseardhjeje edhe nga drejtues të tjerë të komunitetit ku jetoni ose nga përfaqësues të qeverisë.

Ju do të lexoni ose përsërisni me zë të lartë Betimin e shtetësisë australiane së bashku me personat e tjerë që kanë vendosur të bëhen shtetas australianë. Kjo është pjesa më e rëndësishme e ceremonisë. Ju nuk mund të bëheni një shtetas australian pa bërë betimin ndaj Australisë.

Ju nuk jeni i detyruar, por nëse keni dëshirë, ju mund të sillni dhe të mbani me vete një libër të shenjtë gjatë kohës që betoheni.

Drejtues të komunitetit tuaj ose përfaqësues të qeverisë do të mbajnë fjalime të shkurta mbi domethënien e shtetësisë. Ju do të merrni Certifikatën e shtetësisë australiane dhe mund t'ju jepet edhe ndonjë dhuratë e vogël nga komuniteti. Të gjithë do të këndojnë 'Advance Australia Fair' i cili është himni kombëtar australian. Pas

ceremonisë së shtetësisë, ju do të mund të takoni dhe festoni me australianë të tjerë.

Ne ju urojmë çdo sukses me rastin e marrjes së shtetësisë australiane dhe në vazhdimin e një jete paqësore dhe të frytshme në Australi.

## Për më shumë informacion

Vizitoni faqen në internet të shtetësisë australiane në [www.citizenship.gov.au](http://www.citizenship.gov.au).





# Fillimi i pjesës për të cilën do të pyeteni





# PJESA NJË

---

## Australia dhe populli i saj

# Australia dhe populli i saj

Në ceremoninë e shtetësisë, ju betoheni se do të jeni besnikë ndaj Australisë dhe popullit të saj. Prandaj është e rëndësishme, që ju të keni njohuri për popullsinë dhe komunitetin australian, duke përfshirë edhe trashëgiminë indigjenase. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptoni shndërrimin e Australisë nga një fillim i pasigurt si një koloni britanike, në një komb shumëkulturore të suksesshëm dhe të qëndrueshëm që është sot.

Në këtë pjesë, ju do të lexoni për disa nga ngjarjet që kanë kontribuar në historinë tonë. Aty ka informacione për shtetet dhe territoret tona, si dhe informacione mbi traditat dhe simbolet që ne me krenari dallohem si australianë.

## Populli aborigjen dhe ai i Ishujve Torres Strait

Banorët e parë të Australisë janë populli aborigjen dhe ai i Ishujve Torres Strait, të cilët kanë kulturat dhe traditat më të vjetra në të vazhdueshme botë.

Historikisht, populli aborigjen e ka prejardhjen nga kontinenti australian dhe Tasmania. Arkiva arkeologjike tregon se populli aborigjen erdhën në Australi rreth 65.000 me 40.000 vite më parë; megjithatë, populli aborigjen beson se ata janë epiqendra e historisë së krijimit të kësaj toke dhe se këto histori të krijimit nisin që nga kohët më të hershme të krijimit. Banorët e Ishullit të Torres Strait janë nga ishujt midis majës së Queensland-ës dhe Papua New Guinea-s.

Popujt indigjenë kanë të njëjtat besime dhe tradita të cilat i praktikojnë edhe sot e kësaj dite. Ata kanë lidhje të thellë me tokën, e cila shpjegohet në historitë, në artin dhe vallet e tyre. Kulturat indigjene janë të ndryshme dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të identitetit kombëtar të Australisë.

Më shumë informacion mbi popullin aborigjen dhe atë të Ishujve Torres Strait mund të gjendet në kapitujt *Pjesa 5, Australia në ditët e sotme* dhe *Pjesa 6, Historia jonë australiane*.

## Ditët e hershme të kolonizimit evropian

Kolonizimi evropian filloi më 26 janar 1788, me mbërritjen e 11 anijeve të para me të dënuar, e cila njihet gjithashtu edhe si "Flota e Parë" që mbërriti nga Britania e Madhe.

Në atë kohë, ligjet britanike ishin shumë të ashpra dhe burgjet nuk mund të përballonin dot numrin e madh të të dënuarve për krimet e tyre. Për të zgjidhur këtë problem, Qeveria Britanike vendosi të transportojë këta të dënuar në pjesën tjetër të botës; në koloninë e re të New South Wales.

Guvernatori i parë i kolonisë së New South Wales, ishte Kapiteni Arthur Phillip. Kolonia arriti të mbijetonte dhe të zhvillohej gjithashtu, me mbërritjen e të dënuarve të tjerë si dhe të ardhësve të lirë Koloni të tjera u themeluan në pjesë të tjera të vendit. Më shumë koloni u krijuan në pjesë të tjera të Australisë.

Të ardhurit e parë të lirë ishin nga Britania e Madhe dhe Irlanda. Kjo trashëgimi britanike dhe irlandeze ka pasur një influencë të madhe në historinë, kulturën dhe institucionet politike të Australisë.

Në 1851, në kolonitë e New South Wales dhe Victoria-s u zbulua floriri. Njerëz nga gjithë bota erdhën në këto koloni për të provuar fatin se mos bëhen të pasur. Kinezët ishin emigrantët e parë jo-evropianë, që erdhën në grupe të mëdha në këtë periudhë. Brenda 10 vjetësh popullsia e Australisë shënoi një rritje që tejkaloi dyfishimin.



## Kombi australian

Në vitin 1901, kolonitë u bashkuan në një federatë shtetesh që u quajt, Komonuelthi i Australisë. Në atë kohë u formuan institucionet tona demokratike nën Kushtetutën australiane, duke përfshirë parlamentin tonë kombëtar, qeverinë dhe Gjykatën e Lartë. Në vitin 1901, popullsia australiane numëronte rreth katër milion banorë. Ky numër nuk përfshin popullin aborigjen dhe atë nga Ishujt Torres Strait, pasi deri në referendumin e vitit 1967 ata nuk përfshiheshin në numërimet zyrtare të popullsinë australiane.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit të 20-të, niveli i emigracionit pati ngritje dhe ulje. Kishte programe për të inkurajuar aktivisht emigrantët britanikë që të vinin për të jetuar këtu, dhe shumë prej tyre erdhën.

Një valë e re emigrantësh jo-britanikë erdhi pas Luftës së Dytë Botërore, kur në Evropë, miliona njerëz lanë vendet e tyre. Një numër i madh i këtyre njerëzve erdhi në Australi për të ndërtuar një jetë të re.

Në vitet e fundit, programet tona të imigracionit dhe refugjatëve kanë sjellë në Australi njerëz nga e gjithë bota. Ata kanë ardhur këtu për t'u bashkuar me familjet e tyre, të ndërtojnë një jetë të re në një vend të ri, të largohen nga varfëria, lufta apo persekutimi.


Diversiteti i popullsisë së Australisë është rritur gjatë dy shekujve të fundit. Kjo shoqëri e larmishme dhe e prosperuar rrit lidhjen e Australisë me botën. Ndërsa nga një anë ne festojmë shumëllojshmërinë e australianëve, nga ana tjetër ne synojmë të ndërtojmë një komb të bashkuar dhe unifikuar.

Gjuha kombëtare e Australisë është gjuha angleze. Është pjesë e identitetit tonë kombëtar. Për të ruajtur vlerat australiane, emigrantët duhet të mësojnë dhe të përdorin gjuhën angleze në mënyrë që t'i ndihmojë ata të marrin pjesë në shoqërinë australiane. Komunikimi në gjuhën angleze është gjithashtu ndihmë e madhe për të punuar dhe jetuar në Australi.

Gjuhët e tjera vlerësohen gjithashtu, duke përfshirë mbi 100 gjuhë të zhduktura aborigjene dhe të ishujve Torres Strait.

# Shtetet dhe territoret e Australisë

Komonuelthi i Australisë është një federatë shtetesh dhe territoresh. Gjithsej janë gjashtë shtete dhe dy territore brenda Australisë. Kanberra është kryeqyteti i Australisë dhe çdo shtet e territor ka kryeqytetin e vetë.



| Shteti                                                                | Kryeqyteti          |
|-----------------------------------------------------------------------|---------------------|
| Liqenet Willandra (Willandra Lakes) në New South Wales                | Sidnej (Sidney)     |
| Viktoria (Victoria) (Vic.)                                            | Melburn (Melbourne) |
| Kuinsland (Queensland) (Qld)                                          | Brisban (Brisbane)  |
| Australi Perëndimore (Western Australia) (WA)                         | Perth (Perth)       |
| Australi e Jugut (South Australia) (SA)                               | Adelaide (Adelaide) |
| Tazmania (Tasmania) (Tas.)                                            | Hobart (Hobart)     |
| Territori                                                             | Kryeqyteti          |
| Territori Kryeqytetas Australian (Australian Capital Territory) (ACT) | Kanberra (Canberra) |
| Territori verior (Northern Territory) (NT)                            | Darvin (Darwin)     |



## Shtetet

**New South Wales** është kolonia e parë që u krijua nga britanikët. Sidnej (Sidney) është kryeqyteti i New South Wales dhe është qyteti më i madh i vendit. Ura në Skelën e Sidnejt (Sidney's Harbour Bridge) dhe Pallati i Operës (Opera House) janë dy ikona të kombit tonë.



**Viktorija** është shteti më i vogël i kontinentit. Kryeqyteti i Viktorias është Melburni. Shumë ndërtesa të bukura në Viktorija, u ndërtuan gjatë kohës që u zbulua floriri gjatë viteve 1850. Ikonat e Victoria-s përfshijnë Melbourne Cricket Ground, 12 apostujt dhe ndërtesën mbretërore të ekspozitave.



**Queensland** është shteti i dytë më i madh i kontinentit. Brisbanë është kryeqyteti i Queensland-ës. Ishujt Torres Strait (Torres Strait Islands) shtrihen në veri të shtetit dhe e famshmja në botë 'Great Barrier Reef' shtrihet përgjatë bregdetit në zonën lindore të shtetit. Queensland ka pyje tropikale, zona me temperatura të buta bregdetare dhe një zonë të thatë në brendësi.



**Australia Perëndimore** është shteti me territor më të madh. Perth është kryeqyteti i Australisë Perëndimore. Pjesa lindore e shtetit është pothuajse shkretëtirë, ndërsa Jug-perëndimi është i pasur në agrikulturë dhe prodhim vere. Në këtë shtet ndodhen minierat më të mëdha. Ikonat e Australisë Perëndimore përfshijnë zonën bregdetare Ningaloo (Nigaloo Coast), lumin Margaret dhe rajonin Kimberli (Kimberley).



**Australia Jugore** ka një vijë bregdetare të thyer dhe zonat më të famshme të prodhimit të verës. Adelaide që është kryeqyteti është një shëmbull i një arkitekture të bukur kolonialiste. Ikonat e Australisë Jugore përfshijnë Luginën Barosa (Barossa Valley) dhe Flinders Ranges.



**Tasmania** është shteti më i vogël, i shkëputur nga pjesa tjetër e kontinentit nga ngushtica Bass Strait. Kryeqyteti i Tasmania-s është Hobart. Pjesa më e madhe e ishullit ka shumë vende të paprekura. Ikonat e Tasmanisë përfshijnë malin Cradle, portin Artur (Port Arthur) dhe Gjirin e Zjarreve (Bay of Fires).



## Territoret

**Territori Kryeqytetas Australian** ndodhet midis Sidnejt dhe Melburnit. Është vendndodhja e kryeqytetit të vendit, Kanberra. Kanberra është shtëpia e institucioneve të rëndësishme kombëtare, si p.sh Godina e Parlamentit dhe Gjykata e Lartë.



**Territori Verior** Northern Territory ka zonën tropikale në Veri dhe zonën e shkretëtirës së kuqe në jug. Kryeqyteti është Darwin. Territori Verior përfshin Uluru, Kata Tjuta dhe Kanionin e Mbretërve (Kings Canyon).





## Traditat

### Mirëseardhja në vend dhe pranimi i protokolleve të vendit

‘Mirëseardhja në vend’ është një praktikë kulturore që kryhet nga një kujdestar i banorëve aborigjenë dhe të Ishujve Torres Strait në rajonin lokal, sipas të cilit mirëpreten vizitorët në tokën e tyre tradicionale. Kjo praktikë kryhej tradicionalisht për t’u siguruar vizitorëve gjatë asaj kohe një udhëtim të sigurt dhe me mbrojtje.

‘Mirëseardhja në vend’ mund të kryhet në shumë forma, që përfshijnë këngë, kërcime, ceremoni tymosje ose fjalime në gjuhën tradicionale ose në anglisht.

‘Mirëseardhja në vend’ është pjesa e parë e hapjes së çdo evenimenti.

‘Pranimi në vend’ është një mundësi për t’u njohur me grumbullimet në tokën e popullit aborigjen dhe të Ishujve Torres Strait; shprehet rrespekti ndaj Kujdestarëve Tradicionalë, veçanërisht të Moçmëve të së shkuarës dhe të së tashmes; shprehet respekti ndaj popullit aborigjen dhe të Ishujve Torres Strait gjatë pjesëmarrjes.

‘Pranimi në vend’ është zakonisht pjesë e ‘Mirëseardhjes në vend’ dhe ‘Mikpritjes’ në takime dhe evenimente. Gjithkush mund të organizojë një ‘Mirëseardhje në vend’. Në takime/evenimente kjo zakonisht kryhet nga Kryetari ose Mjeshtri i Ceremonive.

Këto praktika përdoren për të respektuar popullin aborigjen dhe atë nga Ishujt Torres States.



## Ditë të rëndësishme për australianët

### Dita Kombëtare e Australisë

Më 26 janar të çdo viti, ne festojmë Ditën Kombëtare të Australisë. Dita Kombëtare e Australisë është ditë pushimi në të gjitha shtetet dhe territoret e Australisë. Është përvjetori i ardhjes së Flotës së Parë nga Britania e madhe në vitin 1788.

Në Ditën Kombëtare, komunitetet në të gjithë Australinë refektojnë mbi historinë tonë dhe njerëzit që kanë kontribuar në arritjet tona të përbashkëta. Është ngjarja më e madhe publike në Australi.

Dita Kombëtare e Australisë ka të bëjë me njohjen dhe festimin e kontributit që çdo australian i jep kombit tonë bashkëkohor dhe dinamik: nga popujt tanë aborigjen dhe nga Ishujt Torres Strait – që kanë qenë këtu për afro 65.000 vjet – për ata që kanë jetuar këtu për breza dhe ata që kanë ardhur nga të gjitha cepat e globit për ta quajtur vendin tonë shtëpinë e tyre. Dita kombëtare e Australisë festohet përmes evenimenteve në mbarë Australinë, përfshirë ceremonitë e shtetësisë.

Gjatë festimeve të Ditës Kombëtare të Australisë, Kryeministri shpall çmimet 'Australian i më i shquar i vitit', në Kanberra.

### Dita e Anzac (Anzac Day)

Dita e Anzac mbahet në 25 prill të çdo viti. Dita Anzac është emëruar pas Korpusit të Ushtrisë Australiane dhe të Zelandës së Re, të cilat zbarkuan në Gallipoli në Turqi gjatë Luftës së Parë Botërore më 25 prill 1915.

Dita e Anzac, është një ditë solemne ku ne përkujtojmë sakrificën e australianëve që luftuan dhe ranë në luftë, në konflikte dhe operacione paqësore. Ne nderojmë gjithashtu kurajën dhe vendosmërinë e gjithë burrave dhe grave dhe refektojmë mbi kuptimet e shumta të luftës.

Më shumë informacion për festat e rëndësishme kombëtare dhe festimet mund të gjenden në kapitullin *Pjesa 5, Australia në ditët e sotme*.



# Flamujt e Australisë

Australia ka tre flamuj zyrtarë: Flamujt e tjerë njihen zyrtarisht dhe mund të ngrihen në komunitet, duke përfshirë flamurin australian aborigjen dhe flamurin e Ishujve Torres Straits.

Çdo shtet dhe territor ka flamurin përkatës, i cili paraqitet në faqen 11.

## Flamuri kombëtar australian

Flamuri kombëtar australian është në ngjyrë blu, të bardhë dhe të kuqe.

- Flamuri i Britanisë së Madhe, siç njihet ndryshe 'Union Jack' ndodhet në këndin sipër majtas. Flamuri tregon lidhjen e historisë sonë me kolonizimin britanik dhe ligjet e institucionet e trashëguara si rezultat i tij.
- Ylli i Komonuelthit ndodhet nën 'Union Jack'. Ky yll ka shtatë cepa, një për secilin nga gjashtë shtetet dhe një tjetër për territoret.
- Kryqi i Jugut (The Southern Cross), në të djathtë, është një grup yjesh që ne i shikojmë në qiellin e hemisferës jugore.



## Flamuri australian aborigjen

Flamuri australian aborigjen është në ngjyrë të zezë, të kuqe dhe të verdhë.

- Gjysma e pjesës së sipërme është e zezë dhe përfaqëson popullin aborigjen të Australisë.
- Gjysma e poshtme është e kuqe dhe përfaqëson planetin tonë dhe një lidhje shpirtërore me tokën.
- Rrethi i verdhë përfaqëson diellin.



## Flamuri i Ishujve Torres Straits

Flamuri i Ishujve Torres Strait është në ngjyrë të jeshile, blu, të zezë dhe të bardhë.

- Vizat e jeshile paraqesin tokën.
- Pjesa blu në qendër, paraqet detin.
- Vizat e zeza përfaqësojnë popullin e Ishujve Torres Strait.
- Modeli i flokëve të kërcimtares në qendër është një simbol për gjithë banorët e Ishujve Torres Strait.
- Cepat e yllit të bardhë përfaqësojnë grupet e ishujve në ngushticën Torres.



# Simbolet e Australisë

## Stema e Australisë

Stema e Komonuelthit është simboli zyrtar i Komonuelthit të Australisë. Ajo përfaqëson unitetin tonë kombëtar. Gjithashtu identifikon autoritetin dhe tiparet e Komonuelthit të Australisë.

- Mburoja në qendër, përfaqëson gjashtë shtetet dhe federatën.
- Një kangur dhe një struc mbajnë mburojën në të dyja anët. Kangurët janë kafshë vendase australiane dhe strucët janë shpendë vendas australianë.
- Një Yll i artë i Komonuelthit qëndron në majë të mburojës.
- Sfondi është i përbërë nga mimozat e verdha, që është lulja kombëtare australiane.



## Stema australiane

Lulja kombëtare australiane është mimoza e verdhë. Kjo pemë e vogël rritet kryesisht në jug-lindje të Australisë. Në pranverë ka gjethe të jeshile të shndritshme dhe shumë lule të verdha. Çdo shtet apo territor i Australisë, ka stemën e vetë florale.



## Ngjyrat kombëtare të Australisë

Ngjyrat kombëtare të Australisë janë e jeshilja dhe e verdha, që janë edhe ngjyrat e mimosës. Uniformat e ekipeve tona sportive kombëtare janë zakonisht të verdha dhe jeshile.



## Guri i çmuar i Australisë

Opali është guri i çmuar i Australisë. Sipas një legjende aborigjene shpjegohet se një ylber pasi preku tokën krijoi ngjyrat e opalit.





# Himni kombëtar i Australisë

“Përparo e bukura Australi” (‘Advance Australia Fair’) është himni kombëtar i Australisë. Himni këndohet nëpër ngjarje të rëndësishme kombëtare, duke përfshirë ceremonitë e marrjes së shtetësisë australiane dhe evenimente të mëdha sportive.



## Advance Australia Fair

*Australians all let us rejoice,  
For we are one and free;  
We've golden soil and wealth for toil;  
Our home is girt by sea;  
Our land abounds in nature's gifts  
Of beauty rich and rare;  
In history's page, let every stage  
Advance Australia Fair.  
In joyful strains then let us sing,  
Advance Australia Fair.*

*Beneath our radiant Southern Cross  
We'll toil with hearts and hands;  
To make this Commonwealth of ours  
Renowned of all the lands;  
For those who've come across the seas  
We've boundless plains to share;  
With courage let us all combine  
To Advance Australia Fair.  
In joyful strains then let us sing,  
Advance Australia Fair.*



## PJESA DY

---

# Vlerat demokratike, të drejtat dhe liritë në Australi

# Vlerat demokratike, të drejtat dhe liritë në Australi

Në ceremoninë e marrjes së shtetësisë, betoheni që ju respektoni të drejtat dhe liritë e australianëve si dhe besoni në vlerat demokratike tona. Është e shumë e rëndësishme që ju të kuptoni vlerat e demokracisë së Australisë dhe të drejtat e liritë që ndahen mes australianëve.

Kjo pjesë e broshurës rendit këto besime, të drejta dhe liri. Për më shumë informacion, shikoni kapitullin *Pjesa 4, Vlerat australiane*.

## Vlerat tona demokratike

### Demokraci parlamentare

Sistemi qeverisës i Australisë është demokraci parlamentare. Si pjesë e këtij sistemi, fuqia e qeverisë vjen nga populli australian, sepse shtetasit australianë votojnë rregullisht për njerëz që t'i përfaqësojnë në parlament. Përfaqësuesit në parlament duhet t'i përgjigjen popullit, nëpërmjet zgjedhjeve, për vendimet që ata marrin.

### Rendi ligjor

Të gjithë australianët janë të barabartë përpara ligjit. Rendi ligjor nënkupton që asnjë person, grup apo rregull fetar të qëndrojnë mbi ligjin. Të gjithë njerëzit, përfshirë edhe ata persona që mbajnë poste të larta në komunitetin australian duhet të respektojnë ligjet. Këtu përfshihen qeveria, udhëheqësit e komunitetit dhe feve të ndryshme, si dhe njerëzit e biznesit dhe policinë.

### Jetesë paqësore

Ne jemi krenarë që jetojmë në një vend paqësor, me një sistem qeveritar të qëndrueshëm. Australianët besojnë se ndryshimi duhet të vijë nëpërmjet diskutimeve, përpjekjeve paqësore dhe proceseve demokratike. Ne jemi kundër dhunës si rrugë për të ndërruar ligjin apo mendjen e një personi.

### Respekt për të gjithë, pavarësisht prejardhjes

Sistemi demokratik i Australisë bazohet në parimin se çdo individ, pavarësisht formimit arsimor, ka të drejta dhe është i barabartë përpara ligjit australian. Presim nga të gjithë australianët të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt, pavarësisht racës, origjinës, gjinisë, preferencave seksuale, gjendjes civile, moshës, paaftësisë, trashëgimisë, kulturës, pasurisë apo besimit fetar.



## Liritë tona

### Liria e fjalës dhe shprehjes

Liria e shprehjes është një ndër vlerat themelore australiane dhe përforcon sistemin tonë demokratik. Liria e fjalës, lejon njerëzit të thonë dhe të shkruajnë atë që mendojnë si dhe të diskutojnë mendimet e tyre me të tjerët. Ne mund të kritikojmë qeverinë, të protestojmë në mënyrë paqësore ndaj vendimeve të saj apo të bëjmë fushatë për të ndryshuar ligjet.

Liria e të shprehurit i lejon njerëzit të shprehin pikëpamjet e tyre nëpërmjet artit, filmit, muzikës dhe literaturës. Ne jemi të lirë të mblidhemi me njerëz të tjerë në vende private ose publike për diskutime politike apo shoqërore.

Ligjet e Australisë duhet të respektohen në çdo kohë, madje edhe gjatë përfshirjes në veprimtari të lirisë së fjalës dhe të së shprehurit. Në të njëjtën kohë ne duhet të respektojmë lirinë e fjalës dhe të të shprehurit të njerëzve të tjerë.

### Liria e anëtarësimit në shoqata

Liria e anëtarësimit në shoqata është e drejta për të krijuar ose për t'u anëtarësuar në shoqata për të ndjekur qëllime të përbashkëta. Për shembull, australianët janë të lirë të marrin pjesë në çdo shoqatë të ligjshme, si p.sh. parti politike, unione punëtorësh, fetare, kulturore apo organizata shoqërore. Njerëzit gjithashtu kanë të drejtë të mos marrin pjesë në këto grupe dhe nuk mund të detyrohen.

Australianët mund të dalin në protesta me të tjerë dhe të protestojnë kundër vendimeve të qeverisë apo të një organizate. Megjithatë ligjet e Australisë duhet të respektohen gjithmonë. Kjo do të thotë se këto grumbullime duhet të jenë paqësore dhe nuk duhet të dëmtojnë asnjë person apo pronë.

### Liria fetare

Australia ka një histori Kristiano-Judite dhe shumë australianë e përshkruajnë veten e tyre si kristianë por në Australi ka njerëz të të gjitha besimeve të mëdha fetare. Australia ka pushime kombëtare në ditët Kristiane si p.sh. e Premtja e Mirë, e Diela e Pashkëve si dhe Dita e Krishtlindjeve.

Qeveria dhe ligji i trajton të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë, pavarësisht përkatësisë dhe besimit fetar. Qeveria australiane është një qeveri laike, gjë që do të thotë që operon veçmas kishave apo besimeve të tjera fetare. Australia nuk ka besim fetar zyrtar. Populli australian është i lirë të ndjekë çdo lloj feje, sipas dëshirës. Mund të zgjidhet të mos ndiqet një besim fetar.

Megjithatë ligjet e Australisë duhet të respektohen edhe kur zgjidhet përfshirja në praktika fetare. Në rast konflikti midis ligjit australian dhe një praktike fetare, ligji australian prevalon.



## Barazitë tona

Në Australi ka një numër të caktuar ligjesh, të cilat sigurojnë që një person nuk trajtohet ndryshe nga persona të tjerë në bazë të gjinisë, racës, paaftësisë apo moshës.

### Barazia gjinore

Meshkujt edhe femrat kanë të drejta të barabarta në Australi. Diskriminimi i një personi për arsye të gjinisë është e jashtëligjshme në Australi.

### Shanse të barabarta dhe 'vazhdimësi e drejtë' ('fair go')

Australianët vlerësojnë shanset e barabarta në shoqërinë tonë; kjo quhet shpesh një "zgjedhje e drejtë". Kjo do të thotë që atë që dikush e arrin në jetë, duhet ta arrijë nëpërmjet një pune të lodhshme dhe në bazë të talentit të tij dhe jo bazuar në pasuritë ose prejardhja e tyre. Kështu garantohet që të mos ketë dallime në shoqërinë australiane.

## Përgjegjësitë dhe privilegjet e shtetësisë australiane

Kur të bëheni shtetas australian, ju do të keni përgjegjësi dhe privilegje të reja.

### Përgjegjësitë – çfarë do t'i jepni ju Australisë

Si shtetas australian ju duhet të:

- respektoni ligjet e Australisë
- votoni në zgjedhjet federale, të shteteve apo territoreve dhe në referendum
- të mbrojnë Australinë në rast nevojë
- të marrin pjesë në një juri në rast se thirreni.

### Privilegjet – çfarë do t'u japë juve Australia

Si shtetas australian ju mund të:

- votoni në zgjedhjet federale, të shteteve apo territoreve dhe në referendum
- regjistroni fëmijët e lindur jashtë Australisë si shtetas australianë bazuar në prejardhje
- aplikojnë për punësim në Shërbimin Publik të Australisë ose në Forcat e Armatosura australiane
- kërkojnë të drejtën për t'u zgjedhur në parlament
- aplikojnë për pasaportë australiane dhe hyjnë prapë në Australi lirisht
- kërkojnë ndihmë pranë një përfaqësuesi australian jashtë Australisë.



## Përgjegjësitë

### Respektoni ligjet e Australisë

Përfaqësuesit tanë në qeveri krijojnë ligje për të pasur një shoqëri të qetë, të sigurt dhe të lirë si dhe për të mbrojtur të drejtat tona. Të gjithë shtetasit australianë dhe njerëzit e tjerë që jetojnë në Australi duhet të respektojnë ligjet e vendit.

Më shumë informacion për ligjet më të rëndësishme në Australi mund të gjendet në kapitullin *Pjesa 3, Qeveria dhe ligjet në Australi*.

### Votimi në zgjedhjet federale, të shteteve apo territoreve dhe në referendum

Votimi është një përgjegjësi e rëndësishme, e drejtë dhe privilegj për të gjithë shtetasit që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Votimi në zgjedhjet federale, të shteteve apo territoreve, si dhe në referendum, është përgjegjësi e çdo shtetasi australian që ka mbushur moshën 18 vjeç, vota e të cilit mund të ndryshojë Kushtetutën e Australisë. Në këtë mënyrë ne kemi rolin tonë në mënyrën se si qeveriset vendi dhe kontribuojmë në të ardhmen e Australisë.

Votimi në zgjedhjet federale, të shteteve apo territorit është i detyrueshëm. Pjesëmarrja në zgjedhjet e lokale të qeverisë nuk është e detyrueshme në disa shtete.

Më shumë informacion për Kushtetutën australiane mund të gjeni në kapitullin *Pjesa 3, Qeveria dhe ligjet në Australi*.

### Mbrojtja e Australisë në rast nevoje

Edhe pse shërbimi ushtarak në Australi është më dëshirë, një prej përgjegjësi të shtetasve australianë është të mbrojnë Australinë në rast nevoje. Në rast nevoje është jetike që gjithë shtetasit australianë të angazhohen të marrin pjesë së bashku në mbrojtjen e kombit dhe të jetës sonë.

### Marrja pjesë në një juri në rast se thirreni

Shërbimi në juri është një përgjegjësi për shtetasit australianë të moshës mbi 18 vjeç. Juria është një grup burrash dhe grash australianë të thjeshtë të cilët dëgjojnë evidencën që jepet në një gjykatë dhe vendosin nëse një person është fajtor apo jo.

Shtetasit australianë që janë regjistruar në listat zgjedhore mund të thërriten të shërbejnë në një juri. Shërbimi i jurisë ndihmon për të bërë të sigurt që sistemi gjyqësor është i hapur dhe i drejtë.

## Përfitimet

Apliko për punësim në Shërbimin Publik të Australisë dhe në Forcat e Armatosura australiane. Një privilegj i shtetësisë australiane është aplikimi për të punuar në Shërbimin Publik australian dhe të punoni në qeverinë australiane, si p.sh. në Services Australia, ose në Zyrën Tatimore të Australisë (ATO).

Shtetasit australianë sipër kanë të drejtë gjithashtu të aplikojnë për një karrierë në Forcat e Armatosura australiane (Ushtri, Marinë dhe Forcat Ajrore).

### E drejta për t'u zgjedhur në parlament

Shtetasit australianë mbi 18 vjeç mund të kërkojnë të zgjidhen si deputetë në parlament në nivel federal, atë të shtetit apo territorit. Është nder dhe përgjegjësi serioze të shërbesh në parlamentin australian.

### Aplikoni për pasaportë australiane dhe hyni prapë në Australi lirisht

Kur bëheni shtetas australian, ju keni të drejtë të jetoni të lirë në Australi. Ju keni të drejtë të aplikoni për pasaportë australiane. Si shtetas australianë ju jeni të lirë të udhëtoni jashtë Australisë dhe të ktheheni në Australi.

### Kërkoni ndihmë pranë një përfaqësuesi australian jashtë Australisë

Australia ka në shumë vende ambasada, komisione të larta ose konsullata. Kur ndodheni jashtë Australisë, në rast nevojë ju mund të kërkon ndihmë nga këto zyra. Në ndihma përfshihen raste urgjente si p.sh. luftë civile apo fatkeqësi natyrore.

Zyrtarët në këto zyra, mund të lëshojnë gjithashtu edhe pasaporta në rast urgjence dhe të sigurojnë mbështetje dhe këshilla në raste aksidentesh, sëmundje të rënda ose vdekje.

Kur ndodheni në një vend tjetër, ju duhet të respektoni ligjet e atij vendi.

### Regjistroni fëmijët e lindur jashtë Australisë si shtetas australianë bazuar në prejardhje

Shtetasit australianë mund aplikojë për përfitimin e shtetësisë australiane për fëmijën që ka lindur jashtë shtetit duke.

## Pjesëmarrja në shoqërinë australiane

Australia inkurajon gjithë shtetasit të aktivizohen në shoqëri. Qytetarët aktivë marrin përgjegjësinë dhe privilegjin e formimit të së ardhmes së Australisë. Për shembull, mund të bëheni pjesë e një lagjeje dhe organizate të komunitetit lokal, mund të ofroni kontributin tuaj vullnetar për të kryer punë sociale dhe komunitare, të anëtarësoheni në organizata kulturore dhe të merrni pjesë aktivisht në jetën politike.

Një kontribut tjetër që ju i jepni komunitetit australian është edhe pagesa e taksës. Taksa paguhet nga rroga që ju merrni, e cila mund të sigurohet nga puna, biznesi që ju keni, apo investimet tuaja, dhe taksat mbledhen nga ATO. Gjithashtu aplikohen taksa mbi shumë mallra dhe shërbime. ATO garanton që gjithë qytetarët të njihen me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre për të paguar taksën e duhur.

Shumë përfitime që australianët gëzojnë janë bërë të mundura nëpërmjet taksës. Taksat harxhohen në shërbime të tilla si p.sh. shëndetësia, arsimi, mbrojtja, rrugët dhe hekurudhat si dhe shërbimi social.

Duke punuar dhe paguar taksat, ju ndihmoni qeverinë t'i ofrojë këto shërbime komunitetit australian. Gjithashtu, qeveritë e shteteve, territoreve apo këshillat bashkiake mbledhin taksa në mënyrë që të paguajnë për shërbimet që ata ofrojnë. Këto shërbime ndihmojnë që Australia të bëhet një vend i zhvilluar dhe i begatë siç është edhe sot.



# PJESA TRE

---

## Qeveria dhe ligji në Australi



# Qeveria dhe ligji në Australi

Në ceremoninë e shtetësisë, ju zotoheni të mbronni dhe bindeni ligjeve australiane. Sistemi qeverisës i Australisë është demokraci parlamentare. Është e rëndësishme për ju të kuptoni sistemin qeverisës të Australisë, si krijohen dhe si administrohen ligjet në demokracinë tonë parlamentare. Është gjithashtu e rëndësishme për ju si shtetas të kuptoni se si ju keni të drejtën e fjalës në qeverisjen e vendit.

## Si e kam unë të drejtën e fjalës?

### Votimi

Siç paraqitet në Seksionin 2, në Australi, shtetasit mbi 18 vjeç duhet të regjistrohen në mënyrë që të votojnë në zgjedhje federale, të shteteve dhe të territorit, si dhe në referendume kushtetuese.

Në demokracinë parlamentare të Australisë qytetarët kanë të drejtën e fjalës mbi mënyrën e qeverisjes së vendit përmes votës për një person që i përfaqëson në parlament. Nëse nuk jeni regjistruar në rregull, ju nuk do të jeni në gjendje të votoni në zgjedhje.

Votimi është i detyrueshëm në zgjedhje në Australi ose në rast referendumesh mbi ndryshime kushtetuese.

Komisioni Zgjedhor i Australisë (AEC) është një agjencia përgjegjëse e Komonuelthit që merret me zhvillimin e zgjedhjeve federale dhe referendumet, si dhe mbajtjen e listën zgjedhore të Komonuelthit. AEC është e pavarur nga qeveria. Partitë politike ose njerëzit në qeveri nuk mund të ndërhyjnë në vendimet e AEC.

Votimet bëhen sekrete, kështu që ju jeni të lirë dhe të sigurt të votoni kë të doni. Askujt nuk i lejohet të dijë se për kë votojnë qytetarët e tjerë, përveçse kur zgjidhni ta thoni vetë. Nëse nuk votoni dhe nuk keni arsye të fortë, ju do paguani një gjobë. Votimi i detyrueshëm ka të bëjë me atë që njerëzit që ne zgjedhim janë me të vërtetë ato të dëshiruar nga shumica.

### Diskutimi i problemeve me përfaqësuesit tuaj

Qytetarët australianë mund të kontaktojnë përfaqësuesin tuaj të zgjedhur për të ngritur shqetësime mbi politikën e qeverisë. Në këtë mënyrë, çdo australian i thjeshtë mund të thotë fjalën e vet në nxjerrjen e ligjeve dhe politikës që qeveria duhet të ndjekë. Nëse një qytetar i kërkon përfaqësuesit apo përfaqësueses së tij se një ligj duhet të ndryshojë, përfaqësuesi i zgjedhur duhet të marrë në konsideratë sugjerimin e bërë.

# Si e krijuam sistemin tonë qeverisës?

## Federata

Përpara vitit 1901, Australia ishte e përbërë nga gjashtë koloni britanike të ndara dhe që vetëqeveriseshin.

Brenda kufijve të vet, çdo koloni kishte kushtetutën dhe ligjet e veta të mbrojtjes, imigracionit, postës, tregtisë dhe transportit. Megjithatë ky fakt krijoi vështirësi midis kolonive. Tregtia dhe transporti ndërmjet kolonive ishin të shtrenjtë dhe të ngadalshëm. Kolonitë e ndara gjithashtu kishin sisteme të dobëta mbrojtjeje.

Njerëzit deshën t'i bashkonin kolonitë në një komb të vetëm australian për një numër arsyesh. Por më e rëndësishme, ishte se identiteti australian kishte filluar të formohej. Ekipet sportive po përfaqësonin Australinë në arenën ndërkombëtare si dhe një kulturë e veçantë australiane po zhvillohej në këngë popullore, poema, histori apo art.

Bashkimi i Australisë në një komb të vetëm ishte një detyrë e vështirë, por pas njëfarë kohe, ideja për një shtet të vetëm australian u bë realitet. Në 1 janar 1901, kolonitë u bashkuan në një federatë shtetesh të quajtura Komonuelthi i Australisë.


## Kushtetuta australiane

*Dekreti i vitit 1900 i Kushtetutës së Komonuelthit të Australisë* (Kushtetuta e Australisë) është dokumenti ligjor i cili përcakton ligjet bazë të qeverisë australiane. Për herë të parë Kushtetuta australiane u bë ligj, si pjesë e Dekretit Britanik të parlamentit në 1900. Në 1 janar 1901, kur Kushtetuta hyri në fuqi, kolonitë australiane u bënë pjesë e një kombi të pavarur: Komonuelthi i Australisë.

Kushtetuta australiane themeloi Parlamentin e Komonuelthit të Australisë, krijoi Dhomën e Përfaqësuesve dhe Senatin. Kushtetuta krijoi gjithashtu Gjykatën e Lartë të Australisë, e cila ka fuqinë të ushtrojë dhe interpretojë ligjet australiane.

Ndryshime të tjera u bënë në 1967, kur më shumë se 90 për qind e australianëve votuan 'PO' për të lejuar aborigjenët që të numëroheshin në regjistrimet e përgjithshme të popullsisë.

Në referendum, duhet të jetë një shumicë e dyfishtë në mënyrë që Kushtetuta të ndryshohet. Kjo do të thotë që, shumica e votuesve në shumicën e shteteve dhe shumica e votuesve në gjithë Australinë duhet të votojnë për ndryshimin.



# Si kontrollohet fuqia e qeverisë?

Kushtetuta e Australisë ndan pushtetet qeverisëse midis atij legjislativ (Parlamenti), ekzekutiv (Kryeministri dhe Kabineti) dhe gjyqësor (gjyqtarët) për të ndaluar një person apo një grup nga monopolizimi i pushtetit.

## Kompetencat legjislative

Në bazë të kushtetutës, parlamenti ka fuqi legjislative, që do të thotë, ka fuqi të nxjerrë ligje të reja. Parlamenti ka fuqinë për të nxjerrë ligjet dhe ndryshuar ligjet. Parlamenti është krijuar me deputetë të cilët janë zgjedhur nga populli australian.

## Kompetencat zbatuese

Kompetenca zbatuese është fuqia për të zbatuar ligjet. Pushteti ekzekutiv përfshin Kryeministrin, ministrat e qeverisë australiane dhe Guvernatorin e Përgjithshëm. Ministrat janë përgjegjës për departamentet qeverisëse.

## Kompetencat juridike

Gjyqtarët kanë fuqinë të interpretojnë dhe zbatojnë ligjet. Gjykatat dhe gjykatësit janë të pavarur nga parlamenti dhe qeveria.

Këto kompetenca janë shkruar në Kushtetutën australiane.

# Kush është Kryetari i shtetit australian?

Kreu i Shtetit të Australisë është Mbreti i Australisë, Madhëria e Tij Mbreti Charles III.

Mbreti emëron Guvernatorin e Përgjithshëm si përfaqësuesin e tij në Australi, bazuar në këshillat e Kryeministrit. Guvernatori i Përgjithshëm vepron në mënyrë të pavarur nga partitë e tjera politike. Mbreti nuk ka një rol të përditshëm në qeveri.

Në secilin prej shteteve të Australisë ka një guvernator që përfaqëson Mbretin në një rol që është i ngjashëm me Guvernatorin e Përgjithshëm.

## Monarki kushtetuese

Australia është një monarki kushtetuese, që do të thotë se Mbreti është Kreu i Shtetit të Australisë, por duhet të veprojë në përputhje me Kushtetutën. Meqenëse Mbreti nuk jeton në Australi, kompetencat e tij i delegohen Guvernatorit të Përgjithshëm në Australi.

Sistemi australian i demokracisë parlamentare pasqyron traditat britanike dhe ato të Amerikës së Veriut të kombinuara në një mënyrë unike australiane. Në sistemin australian, kryetari i qeverisë australiane është Kryeministri.



Madhëria e Tij Mbreti Charles III

## Roli i Guvernatorit të Përgjithshëm

Guvernatori i Përgjithshëm nuk është anëtar i qeverisë dhe duhet të jetë neutral.

Guvernatori i Përgjithshëm:

- nënshkruan të gjitha projektligjet që janë miratuar nga Parlamenti australian në ligje (kjo quhet Aprovim Mbretëror, Royal Assent)
- përmbush detyra ceremoniale
- miraton emërimin e qeverisë australiane dhe ministrave të saj, gjykatësve federal si dhe zyrtarëve të tjerë
- fillimi i procesit për një zgjedhje federale
- duke vepruar si Komandant i Përgjithshëm i Forcave australiane të Mbrojtjes.

Guvernatori i Përgjithshëm ka gjithashtu kompetenca speciale që njihen si 'kompetenca rezervë' të cilat mund të përdoren vetëm në raste të veçanta.

## Kush janë disa nga udhëheqësit e Australisë?

### Kryetari i Shtetit

Mbreti i Australisë

### Guvernatori i Përgjithshëm

Përfaqësuesi i Kryetarit të Shtetit të Australisë

### Guvernatori

Përfaqësuesi i Kryetarit të Shtetit në secilin shtet australian

### Kryeministri

Kryetari i qeverisë australiane

### Premier

Kryetari i qeverisë së një shteti

### Ministër i Parë

Kryetari i qeverisë së një territori

### Ministër qeverie

Një anëtar parlamenti i zgjedhur nga një kryetar qeverie për të qenë përgjegjës për një fushë të caktuar të qeverisë

### Anëtar i Parlamentit (MP)

Një përfaqësues i zgjedhur nga populli në Parlamentin australian ose në parlamentin e shtetit

### Senator

Një përfaqësues shteti apo territori i zgjedhur në Parlamentin australian

### Kryetar i Bashkisë

Drejtuesi i një këshilli bashkiak

### Anëtar i Këshillit Bashkiak

Një anëtar i zgjedhur i këshillit bashkiak

## Si qeveriset Australia?

### Si qeveriset Australia

Qeveria australiane quhet në njëjtën kohë edhe Qeveria Federale ose Qeveria e Komonuelthit. Qeveria përbëhet nga anëtarët e Parlamentit australian, e cila ka dy Dhoma:

- Dhomën e Përfaqësuesve
- Senatin.

Kur ju votoni në zgjedhje federale, ju zgjidhni deputetët për të dyja dhomat.

## Dhoma e Përfaqësuesve

Dhoma e Përfaqësuesve është një prej Dhomave të Parlamentit të Australisë. Dhoma e Përfaqësuesve quhet gjithashtu edhe Dhoma e Ulët ose Kuvendi i Popullit.

Australia është e ndarë në zona zgjedhore federale. Anëtarët e Parlamentit (MPs) përfaqësojnë popullin që është pjesë e elektoratit të tyre.

Numri i këtyre MP për çdo shtet e territor përcaktohet në bazë të popullsisë që ato kanë. Në total, Dhoma e Përfaqësuesve ka 150 anëtarë të zgjedhur.

Anëtarët e Parlamentit dhe senatorët diskutojnë propozimet për ligjet e reja në Parlamentin australian. Puna kryesore e Dhomës së Përfaqësuesve është diskutimi dhe votimi i propozimeve për ligjet e reja ose ndërrimi i atyre ekzistuese.



Dhoma e Përfaqësuesve

## Senati

Senati është Dhoma tjetër e Parlamentit australian. Senati quhet ndonjëherë edhe Dhoma e Lartë, Dhoma e Rishikimit ose Dhoma e Shteteve. Votuesit nga çdo shtet zgjedh gjithashtu senatorët që do t'i përfaqësojnë në parlament. Shtetet përfaqësohen në mënyrë të barabartë në Senat, pavarësisht numrit të popullsisë së tyre. Në total janë 76 senatorë. Çdo shtet zgjedh 12 senatorë, dhe Territori Kryeqytetas Australian e Territori i Veriut zgjedhin dy senatorë secili.

Senatorët gjithashtu marrin në konsideratë, diskutojnë dhe votojnë ligje të reja ose të ndryshojnë ato të vjetra.



Senati

## Qeveritë e shteteve dhe territoreve

Gjithsej brenda Australisë janë gjashtë shtete dhe dy territore. Çdo shtet ka kushtetutën dhe parlamentin e tij. Qeveritë e çdo shteti apo territori e kanë qendrën në kryeqytetet e tyre. Kryetari i qeverisë së një shteti quhet Premier dhe kryetari i qeverisë së një territori quhet Ministër Kryetar.

Qeveritë e shteteve të Australisë veprojnë në mënyrë të ngjashme me Qeverinë Australiane. Në çdo shtet, Guvernatori përfaqëson Mbretin e Australisë. Në Territorin e Veriut, një Administrator emërohet nga Guvernatori i Përgjithshëm. Roli dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të ngjashme me ato të një Guvernatori të një Shteti.

Shtetet kanë të drejta që njihen nga Kushtetuta, teksa territoret jo. Shtetet kanë të drejtë të kalojnë ligje me të drejtën e tyre, teksa ligjet e territoreve vetëqeverisëse mund të ndryshohen ose tërhiqen nga Qeveria australiane në çdo kohë.

Në zgjedhjet e shteteve dhe territorit, shtetasit australianë votojnë për të zgjedhur përfaqësuesin e zonës së tyre. Këta përfaqësues bëhen deputetë të parlamentit të një shteti apo territori.

## Qeveria lokale

Shtetet dhe Territori i Veriut janë të ndarë në qendra lokale qeveritare, të cilat mund të quhen qytete, konte, qyteza ose bashki. Çdo zonë ka këshillin e saj bashkiak. Këshillat bashkiakë janë përgjegjëse për planifikim dhe për shpërndarjen e shërbimeve tek komunitetet e tyre. Qytetarët e çdo zone bashkiake votojnë për të zgjedhur këshilltarët e tyre lokalë.



## Çfarë bëjnë tre nivelet e qeverisë?

Ndryshimi kryesor midis tre niveleve qeverisëse është se megjithëse ka mbivendosje të disa prej përgjegjësi, përgjithësisht çdo qeveri ofron shërbime të ndryshme.

### Qeveria australiane është përgjegjëse për:

|                                                    |
|----------------------------------------------------|
| taksat                                             |
| administrimin e ekonomisë kombëtare                |
| imigracionin dhe shtetësinë                        |
| asistencë punësimi                                 |
| shërbimin postar dhe rrjetin e komunikacionit      |
| shërbimin social (pensionet dhe ndihmat familjare) |
| mbrojtjen                                          |
| tregti dhe biznes                                  |
| aeroportet dhe sigurinë e hapësirës ajrore         |
| punët e jashtme (marrëdhëniet me vende të tjera).  |

### Qeveritë e shteteve dhe territoreve janë kryesisht përgjegjëse për:

|                                       |
|---------------------------------------|
| spitalet dhe shërbimet mjekësore      |
| shkollat                              |
| rrugët dhe hekurudhat                 |
| pylltarinë                            |
| shërbimet policore dhe të ambulancave |
| transportin publik.                   |

### Qeveritë lokale (dhe Qeveria e Territorit të Kryeqytetit australian) janë përgjegjëse për:

|                                                                |
|----------------------------------------------------------------|
| shenjat e transportit rrugor, kontrollin e trafikut            |
| rrugët lokale, trotualet, urat                                 |
| kanalet kulluese                                               |
| parqet, këndet e lojërave, pishinat e notit, terrenet sportive |
| ambientet e kampimit dhe parqet e karavanëve                   |
| kontrollin e ushqimeve dhe të mishit                           |
| kontrollin e kafshëve dhe të qetësisë publike                  |
| mbledhjen e plehrave                                           |
| bibliotekat lokale, qendrat komunitare dhe ndërtesat publike   |
| çështje që kanë të bëjnë me kopshtet dhe azilet e të moshuarve |
| lejet e ndërtimit                                              |
| projektet sociale                                              |
| çështje që kanë të bëjnë me çështje mjedisore.                 |

# Çfarë roli luajnë partitë politike në qeverisjen e Australisë?

Një parti politike është një grup njerëzish që kanë pikëpamje të ngjashme sesi të qeveriset vendi. Ata punojnë së bashku në mënyrë që të kthejnë idetë e partisë së tyre në ligje. Partitë kryesore australiane janë Partia Australiane e Punës, Partia Australiane Liberale, Nacionalistët dhe Partia Ambientaliste.

Shumica e deputetëve të parlamentit janë anëtarë të këtyre partive. Por ka edhe politikanë që nuk janë anëtarë të partive politike.

Në Australi, ju jeni të lirë të bëheni anëtar i një partie politike nëse ju doni.

## Si formohet qeveria australiane?

Pas zgjedhjeve federale, qeveria australiane formohet nga partia politike ose koalicioni i partive që kanë shumicën e deputetëve në Dhomën e Përfaqësuesve, formojnë Qeverinë australiane. Drejtuesi i kësaj partie bëhet kryetari i qeverisë australiane, Kryeministri.

Partia politike ose koalicioni i partive që kanë që zënë vendin e dytë për nga numri i deputetëve në Dhomën e Përfaqësuesve, quhet Opozitë. Drejtuesi i saj quhet Drejtuesi i Opozitës.

Kryeministri zgjedh ministrat nga radhët e Deputetëve ose Senatorëve, me qëllim emërimi në tyre si ministra në qeverinë australiane. Guvernatori i Përgjithshëm miraton emërimin e Kryeministrit dhe ministrave.

Ministrat janë përgjegjës për fusha të rëndësishme të qeverisë (që quhen portofole), si p.sh. punësimi, çështjet indigjene ose Thesari i shtetit. Ministrat me portofolet më të vjetra formojnë Kabinetin, i cili merr vendimet më të rëndësishme të qeverisë australiane.

## Si krijohen ligjet?

Parlamenti australian bën ligje të reja ose ndryshon ato që janë në fuqi për të mirën e kombit.

Nëse një deputet i parlamentit australian propozon një ligj të ri ose ndryshime në ligjet ekzistuese, ky propozim quhet Projektligj ("Bill").

Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati e marrin në konsideratë, diskutojnë dhe votojnë nëse ata janë dakord me Projektligjin.

Nëse shumica e deputetëve të çdo Dhome të Parlamentit pranojnë Projektligjin, atëherë ai shkon te Guvernatori i Përgjithshëm.

Guvernatori i Përgjithshëm nënshkruan një projektligj në mënyrë që të bëhet ligj. Ky veprim quhet Aprovim Mbretëror (Royal Assent).

Parlamentet e shteteve apo territoreve i bëjnë ligjet tyre në të njëjtën mënyrë të ngjashme.



## Si zbatohen ligjet?

### Gjykatat

Gjykatat në Australi janë përgjegjëse për interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Gjykatat vendosin nëse një person ka shkelur ligjin apo jo dhe vendosin dënimin. Gjykatat mund të bazojnë vendimin e tyre vetëm në bazë të provave që disponojnë.

### Gjyqtarët dhe magjistratët

Gjykatësi ose magistrati është autoriteti më i lartë në gjykatë. Gjykatësit dhe magjistratët janë të pavarur dhe asnjë nuk mund të ndërhyjë në vendimet e tyre.

Gjyqtarët dhe magjistratët zgjidhen nga qeveria, por qeveria nuk mund t'i shkarkojë nga detyra nëse nuk i pëlqejnë vendimet e tyre.

### Juritë

Në Australi, në bazë të ligjit, një person është i pafajshëm derisa të gjendet fajtor nga një gjykatë. Çdo person ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat kur del para gjykatës.

Në disa raste gjykata do të përdorë një juri për të vendosur nëse një person ka shkelur ligjin. Roli i jurisë është të vendosë në gjykatë nëse një person është fajtor apo i pafajshëm. Juria është një grup njerëzish të thjeshtë që zgjidhen nga populli. Gjyqtari i shpjegon jurisë ligjin. Në një seancë gjyqësore penale, nëse juria e gjen fajtor një person, gjyqtari vendos masën e dënimit.

### Policia

Policia ruan qetësinë dhe rendin publik në komunitet. Është detyra e tyre të mbrojnë pronën dhe jetën. Ata janë të pavarur nga qeveria. Nëse policia beson që dikush ka shkelur ligjin, ata mund ta arrestojnë atë dhe ta nxjerrin para një gjykate. Policia mund të japë dëshmi në gjykatë, por është gjykata që vendos nëse personi është fajtor apo jo.

Shtetet dhe Territori i Veriut kanë forcat policore të tyre. Ajo lufton krimin duke u bazuar në ligjet e shtetit dhe territorit.

Australia ka gjithashtu një forcë policie kombëtare që quhet Policia Federale Australiane (AFP). AFP heton krimet që bëhen ndaj ligjeve federale, p.sh. trafik droge, krime kundër sigurisë kombëtare dhe krime ndaj mjedisit. Policia Federale australiane (AFP) është gjithashtu përgjegjëse për ruajtjen e rendit në kryeqytetin australian.

Policia dhe komuniteti kanë marrëdhënie të mira në Australi. Ju mund të raportoni krimet si dhe të kërkonin ndihmë nga policia e zonës suaj.

Në Australi, është krim serioz t'i japësh rryshfet një oficeri të policisë. Është krim gjithashtu t'i ofrosh rryshfet një oficeri të policisë.

## Veprat penale në Australi

Është e rëndësishme për ju që t'i njihni ligjet australiane. Nëse shkelni një ligj në Australi për të cilin nuk ishit në dijeni, ky fakt nuk ju përjashton nga akuzat, pasi mosnjohja e ligjit nuk është justifikim.

Disa nga krimet më serioze në Australi përfshijnë vrasje, sulme fizike, përdhunime seksuale, dhunë ndaj personit dhe pronës, vjedhje të armatosura, marrëdhënie seksuale me fëmijë ose persona nën moshën ligjore, ngarje e makinës në mënyrë të rrezikshme, përdorim dhe mbajtje ilegale e drogës si dhe mashtrim.

Gjithkush ka të drejtë të përjetojë eksperiencë pozitive dhe marrëdhënie të sigurt me familjet, miqtë dhe personat e dashur. Si në çdo vend tjetër, dhuna ndaj një personi tjetër në Australi është kundër ligjit dhe është një krim serioz. Kjo përfshin, dhunë në shtëpi dhe gjatë martesës, ose siç njihet ndryshe si dhuna në familje. Dhuna në familje përfshin sjellje ose kërcënime që synojnë kontrollin e një partneri duke i shkaktuar frikë ose që çenojnë sigurinë e tyre. Dhuna në familje mund të përfshijë goditje, izolim të një pjesëtari të familjes nga miqtë dhe familja ose kërcënim i fëmijëve ose kafshëve shtëpiake.

Personat që kryejnë krime të kësaj natyre mund të dënohen me burgim, pavarësisht gjinisë. Askush nuk duhet të pranojë kërcënime të rënda apo dhunim.

Nëse ju ose dikush tjetër që njihni ndodhet në rrezik, ju duhet të kontaktoni autoritetet policore. Më shumë informacion është i disponueshëm në [www.respect.gov.au](http://www.respect.gov.au) dhe [www.1800respect.org.au](http://www.1800respect.org.au)

## Shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor

Rregullat e qarkullimit rrugor administrohen nga qeveritë e shteteve apo të territoreve. Njerëzit mund të gjobiten ose të dënohen me burgim për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Drejtimi i automjetit në Australi kërkon që drejtuesi të jetë i pajisur me leje drejtimi dhe automjeti të jetë i regjistruar.

Çdo person që drejton një automjet duhet të vendosë rripin e sigurisë. Foshnjat dhe fëmijët e vegjël duhet të ulen në sedilje të posaçme të miratuara. Ligjet e qarkullimit rrugor janë shumë të rrepta. Drejtimi i automjetit pas përdorimit të drogave ose nëse keni tejkalluar kufijtë maksimal të lejuar të alkoolit në gjak është i jashtëligjshëm. Gjithashtu është kundër ligjit, të flasësh në telefon celular kur nget makinën.



# PJESA KATËR

---

## Vlerat australiane





# Vlerat australiane

Vlerat australiane të bazuara tek liria, respekti, drejtësia dhe barazia e mundësive janë kyçe për të pasur një vend për të jetuar ku mbizotëron siguria, prosperiteti dhe paqja.

Vlerat tona përkufizojnë dhe formojnë vendin tonë dhe përbëjnë arsyen për të cilën shumë njerëz dëshirojnë të përfitojnë shtetësinë australiane.

Shtetësia australiane lidhet me jetesën e përditshme me këto vlera dhe në komunitetin tuaj lokal. Rrjedhimisht është e shumë e rëndësishme që ju të kuptoni vlerat që duhet të respektojnë dhe të ndajnë qytetarët australianë.

## Vlerat tona

### Angazhimi ndaj rendit ligjor

Të gjithë australianët mbrohen nga ligjet dhe nga sistemet tona ligjore. Australianët e kuptojnë rëndësinë e ligjeve për të pasur një shoqëri të qetë dhe të rregullt.

Të gjithë australianët janë të barabartë përpara ligjit dhe asnjë person apo grup nuk është mbi ligjin. Në Australi, të gjithë duhet të zbatojnë ligjet dhe të mos e shkelin atë asnjëherë, përndryshe do të përballen me penaltete. Ju duhet të respektoni ligjin edhe nëse askush nuk ju shikon.

Ligjet australiane vlejnë për të gjithë njerëzit në Australi. Kjo do të thotë pa marrë parasysh prejardhjen ose kulturën tuaj, ju duhet të ndiqni ligjet australiane.

### Demokraci Parlamentare

Sistemi qeverisës i Australisë, është demokraci parlamentare. Ligjet tona përcaktohen nga parlamentet e zgjedhur nga populli. Kjo do të thotë që gjithë Australianët marrin pjesë në qeverisjen e vendit. Fuqia e qeverisë vjen nga populli australian, sepse qytetarët Australianë votojnë rregullisht për njerëz që t'i përfaqësojnë ata në parlament.

Votimi është i detyrueshëm në Australi. Kjo tregon rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje.

## Liria e shprehjes

Njerëzit në Australi duhet të jenë në gjendje të shprehin lirshëm idetë e tyre, për sa kohë që ato nuk bien në kundërshtim me ligjin. Në Australi, njerëzit janë të lirë të mbledhen nëpër vende publike ose private për diskutime shoqërore apo politike. Liria e fjalës, lejon njerëzit të thonë dhe të shkruajnë atë që mendojnë si dhe të diskutojnë mendimet e tyre me të tjerët. Shtypi, televizioni dhe radio kanë të njëjtat liri.

Australianëve u lejohej të protestojnë kundër veprimeve të qeverisë, sepse toleranca ndaj protestës publike paqësore është një pjesë thelbësore e demokracisë.

Asnjëherë nuk është e pranueshme të promovohet dhuna ndaj një personi tjetër ose grupi njerëzish (si për shkak të kulturës, përkatësisë etnike, fesë ose prejardhjes së tyre) sepse është kundër vlerave dhe ligjit australian. Ne nuk mund të ngremë akuza të rreme apo të nxisim të tjerët të thyejnë ligjet. Në të njëjtën kohë ne duhet të respektojmë lirinë e fjalës dhe të shprehurit të njerëzve të tjerë, për sa kohë kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin.

## Liria e anëtarësimit në shoqata

Në Australi njerëzit janë të lirë të marrin pjesë ose të largohen prej çdo grupi vullnetar për sa kohë që e lejon ligji. Njerëzit janë të lirë të marrin pjesë në çdo shoqatë të ligjshme, si p.sh. parti politike, unione punëtorësh, fetare, kulturore apo organizata shoqërore. Individët nuk mund të detyrohen të anëtarësohen në një shoqatë apo të detyrohen të largohen prej saj.

Australianët mund të dalin lirisht në protesta me persona të tjerë, gjë që përfshin edhe protestat kundër vendimeve të qeverisë apo të një organizate. Megjithatë, të gjitha protestat duhet të jenë brenda ligjit. Kjo do të thotë që ato duhet të jenë paqësore, si dhe nuk duhet të dëmtojnë pronën apo njerëz të tjerë.

## Liria fetare

Australia nuk ka besim fetar kombëtar dhe njerëzit në Australi janë të lirë të ndjekin çdo lloj feje, sipas dëshirës. Qeveria i trajton njerëzit njësoj, pavarësisht besimeve të tyre fetare. Sidoqoftë, praktikat fetare nuk duhet të shkelin ligjet Australiane. Ligjet fetarë nuk kanë status ligjor në Australi.

Ligji australian duhet të respektohet nga çdokush në Australi, përfshirë edhe kur ai ndryshon nga ligjet fetarë. Disa praktika fetare apo kulturore si p.sh poligamia (martesa me më shumë se një person në të njëjtën kohë) janë në kundërshtim me ligjet australiane dhe mund të rezultojnë në dënime të rënda ligjore, përfshirë edhe burgimin.

Mungesa e tolerancës fetare është e papranueshme në shoqërinë australiane. Të gjithë njerëzve duhet t'u ofrohet mundësi e barabartë të ndjekin qëllimet dhe interesat e tyre, pavarësisht përkatësisë etnike ose fesë së tyre.



## Barazia e të gjithë njerëzve sipas ligjit

Shoqëria australiane vlerëson barazinë e të gjithë njerëzve, pavarësisht nga gjinia e tyre, orientimi seksual, mosha, paaftësia, feja, raca, ose origjina kombëtare ose etnike. Në Australi ka një numër të caktuar ligjesh të cilat sigurojnë që një person nuk trajtohet ndryshe nga persona të tjerë.

Në Australi ligji zbatohet në mënyrë që njerëzit me prejardhje të ndryshme të mos trajtohen në mënyrë preferenciale. Për shembull, budistët dhe njerëzit e të gjitha besimeve të tjera fetare trajtohen njësoj si të krishterët. Në bazë të ligjit, dy njerëz mund të martohen, pavarësisht gjinisë, përfshirë martesën midis dy meshkujve ose dy femrave.

Meshkujt dhe femrat në Australi kanë të drejta të barabarta dhe u ofrohen shanse të barabarta për të arritur synimet dhe interesat e tyre në jetë. Si meshkujt edhe femrat kanë të drejta të barabarta në të drejtën për arsim, për votim në zgjedhje, përfaqësim në parlament, për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura të Australisë dhe Policisë, si dhe trajtohen me barazi të plotë në gjykata.

Diskriminimi i një personi për arsye të gjinisë është i jashtëligjshëm në Australi. Në Australi, është e drejtë që një grua të punësohet përpara burrit, nëse ajo ka kualifikime dhe aftësi më të mira.

Si meshkujt edhe femrat kanë të drejtë të vendosin vetë për probleme të tilla personale si p. sh. martesa, dhe janë të mbrojtur me ligj në rast kërcënimi apo ushtrimi të dhunës. Dhuna fizike ndaj njërit prej bashkëshortëve apo partnerëve nuk është kurrësesi ei pranueshme dhe përbën vepër penale në Australi.

Divorci është i pranueshëm në Australi. Bashkëshorti ose bashkëshortja mund të bëjnë kërkesë për zgjidhje martese në gjykata edhe nëse bashkëshorti tjetër nuk e dëshiron divorcin.

## Shanse të barabarta dhe “vazhdimësi e drejtë” (“fair go”)

Ne besojmë se të gjithë meritojnë një “vazhdimësi të drejtë” dhe nuk duhet të kufizohen nga asnjë lloj dallimi klasor. Të gjithëve pa dallim formimi u jepet një mundësi e barabartë për të arritur sukses në jetë dhe siguria për të drejta të barabarta ligjore përbën një aspekt të rëndësishëm të drejtësisë në shoqërinë australiane.

Kjo do të thotë që atë që dikush e arrin në jetë, duhet ta arrijë nëpërmjet një pune të lodhshme dhe në bazë të talentit të tij. Kjo nënkupton që një person duhet të punësohet në bazë të aftësive dhe të eksperiencës së punës dhe jo për arsye të gjinisë, gjendjes ekonomike apo kombësisë së tij.

Kur një organizatë duhet të plotësojë një vend të lirë pune, ligji mbështet mundësinë e punësimit të personit me aftësinë dhe përvojën më të mirë për vendin e punës.

Shumë emigrantë të rinj të ardhur në Australi janë bërë drejtues biznesesh, të profesionit të tyre, të artit, të shërbimit publik dhe të sportit, përmes punës këmbëngulëse dhe talenteve.





## Respekti dhe toleranca reciproke

Në Australi, individët duhet të respektojnë lirinë dhe dinjitetin e të tjerëve, si dhe mendimet e zgjedhjet e tyre. Ushtrimi i dhunës ndaj një personi është i jashtëligjshëm në Australi.

Dhuna e çdo forme, përfshirë abuzimin verbal apo fizik, është e jashtëligjshme. Australianët besojnë në mosmarrëveshjet paqësore dhe mbi të gjitha besojnë tek e drejta për të qenë të sigurt nga dhuna dhe frikësimi.

Në Australi, ka ligje shumë të rrepta për moshën e dhënies së pëlqimit për marrëdhënie seksuale që është 16 ose 17 vjeç, në varësi të shtetit ose territorit ku banoni. Për shembull, në Australi, një mashkull 20 vjeç nuk mund të kryejë marrëdhënie seksuale me një vajzë 15 vjeçare, sepse kjo është kundër ligjit në të gjitha shtetet dhe territoret australiane.

Në Australi, veprimet e ligjshme të policisë duhet të mbështeten. Ju duhet t'i bindeni një kërkesë të ligjshme nga policia, sepse të gjithë australianët angazhohen të zbatojnë ligjin.

Australia vlerëson parimet e respektit dhe tolerancës së ndërsjellë. Kjo do të thotë të dëgjoni të tjerët dhe të respektoni pikëpamjet dhe mendimet e tyre, edhe kur ato janë të ndryshme nga tuajat. Njerëzit duhet të tolerojnë njëri-tjetrin kur nuk pajtohen në mendime.

Në Australi nuk ka vend për racizëm. Kjo përfshin krijimin ose shpërndarjen e materialeve raciste në internet ose publikime të tjera dhe komentimet raciste abuzuese në vende publike ose në evenimente sportive.

# Komuniteti ynë

## Kontribuoni

Shtetësia ju jep mundësinë të merrni pjesë plotësisht në ndërtimin e jetës dhe komunitetit të kombit tonë. Kjo do të thotë që jeni gati për të përmbushur detyrimet tuaja si një shtetas australian. Australianët kanë pritshmërinë që kushdo që jeton në Australi duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të kontribuojnë në shoqëri. Të gjithë kanë përgjegjësi të mbështesin veten dhe familjet e tyre, kur janë të gjendje ta bëjnë.

## Dhembshuri për personat në nevojë

Australianët e vlerësojnë “miqësinë”. Ne ndihmojmë njëri-tjetrin në kohë nevojë. Për shembull, kjo mund të nënkuptojë t’i çosh ushqim një fqinji të moshuar, të shoqërosh një shok të doktori apo të vizitosh dikë që është i sëmurë, i dobët apo i vetmuar.

Në këtë frymë miqësie, Australia ka një traditë të fortë të shërbimit komunitar dhe punës vullnetare – për t’u kujdesur për njëri-tjetrin dhe për të forcuar komunitetin. Puna vullnetare është një mundësi e shkëlqyer për të ndarë njohuritë, për të mësuar gjëra të reja dhe rrit ndjenjën e përkatësisë në komunitetin australian. Në Australi ka shumë mundësi për punë vullnetare.

## Anglishtja si gjuhë kombëtare

Shoqëria australiane e vlerëson gjuhën angleze si gjuhën kombëtare të Australisë dhe si një element të rëndësishëm bashkues të shoqërisë. Njerëzit që jetojnë në Australi duhet të bëjnë një përpjekje për të mësuar anglisht.

Është e rëndësishme të mësoni të flisni anglisht sepse ju ndihmon të arsimoheni, të punësoheni dhe të integroheni më mirë në komunitet. Është thelbësore për pjesëmarrjen ekonomike dhe kohezionin social. Aplikantët për shtetësi australiane duhen të angazhohen për të bërë përpjekje të arsyeshme për të mësuar gjuhën angleze, nëse ajo nuk është gjuha e tyre amtare.

## Ndihmë për të pasur një shoqëri të sigurt

Në Australi, secili prej nesh ka përgjegjësinë për të ndihmuar në mbrojtjen e shoqërisë australiane. Për shembull, nëse njerëzit në Australi dyshojnë se miku apo fqinji i tyre po planifikon një akt terrorist, ata duhet ta raportojnë këtë fakt tek autoritetet australiane sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, ne mund të ndihmojmë për të mbrojtur sigurinë e komunitetit tonë.

Në mënyrë të ngjashme, nëse një person në Australi sheh ose ka njohuri për një fëmijë të abuzuar, ai person duhet ta raportojë këtë fakt në polici për të hetuar.

Abuzimi online është i papranueshëm në Australi. Këto veprime quhen shpeshherë quhet abuzim kibernetik. Disa shembuj përfshijnë dërgimin online të fotove ose videove seksuale pa miratim, ngacmimi i një personi online ose komentet raciste në formë abuzive për një person online. Shumë forma të abuzimit kibernetik janë të jashtëligjshme në Australi.

## Besnikëria ndaj Australisë

Në ceremoninë e shtetësisë, shtetasit australianë betohen se do të jenë besnikë ndaj Australisë dhe popullit të saj. Qytetarët australianë gjithashtu mund të mbajnë shtetësinë e një vendi ose shteti tjetër nëse ligjet e atyre vendeve lejojnë. Kjo njihet si shtetësi e dyfishtë, ose e shumëfishtë. Sidoqoftë, edhe nëse një person është gjithashtu një shtetas i një vendi tjetër, një qytetar Australian duhet të ndjekë të gjitha ligjet Australiane në çdo kohë. Disa ligje australiane duhet të ndiqen gjithashtu edhe kur australianët ndodhen jashtë vendit. Për shembull, për australianët është e jashtëligjshme përfshira në marrëdhënie seksuale, në Australi ose jashtë saj, me fëmijë nën 16 vjeç.

Shoqëria Australiane bazohet në detyrimet tona të përbashkëta për të mos dëmtuar interesat dhe sigurinë e Australisë. Për shembull, përdorimi i mediave sociale për të ndarë sekretet zyrtare të qeverisë do të dëmtonte interesat e Australisë. Në mënyrë të ngjashme, promovimi i mosbesimit dhe frikës ndaj një komuniteti etnik do të dëmtonte marrëdhëniet e komunitetit Australian.



Në Australi, ne qëndrojmë të bashkuar në kohë krizash dhe kujdesemi për njëri-tjetrin në kohë të mira dhe të këqija. Gjatë sezonit të zjarreve shkatërrmtare në Australi, në vitet 2019-2020 që rezultoi në humbjen e dhimbshme të jetëve njerëzore, në shkatërrimin e pasurive, në humbjen e jetëve të kafshëve dhe gjallesave e në shkatërrim mjedisor, shumë komunitete multietnike punuan për të mbledhur ndihma në para, veshje dhe ushqime për të ndihmuar personat e prekur nga zjarret. Për shembull, anëtarë të komuniteteve të Kinës, Vietnamit dhe Kamboxhias në Viktoria mbledhën donacione nëpër qendra tregtare dhe prëmes evenimente në komunitete lokale, teksa anëtarët e komunitetit Sikh dhuruan mijëra shishe me ujë për komunitetet dhe zjarrfikësit në Queensland.



## Në përfundim

Institucionet tona demokratike dhe vlerat e përbashkëta australiane kanë krijuar shoqërinë tonë të qëndrueshme dhe të qetë.

Ne jemi pjesëtarë të një kulture të pasur dhe të veçantë. Si një shtetas australian ju do të bëheni pjesë e historisë sonë kombëtare dhe do të kontribuoni në të ardhmen tonë. Australia ju uron mirëseardhjen. Shtetësia është lidhja jonë unike.

# Fjalor i pjesës për të cilën do pyeteni

## Populli aborigjen dhe ai i Ishujve Torres Strait

banuesit origjinal të tokës – në Australi, aborigjenët dhe populli i Ishujve të Torres Strait

**Populli aborigjen dhe i Ishujve Torres Strait në Australi përbën rreth tre për qind të popullsisë australiane.**

## Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut

Një komision i pavarur që shqyrton ankesat mbi rastet e diskriminimit dhe shkeljen e të drejtave të njeriut.

**Incidentet e racizmit mudh të raportohen tek Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut.**

## Shërbimi publik australian

departamentet e qeverisë dhe njerëzit e punësuar prej tyre

**Paul gjeti punë në Shërbimin Publik australian si nëpunës në Services Australia.**

## tubim civile

demonstrata dhe protesta nga një numër i madh njerëzish, zakonisht duke protestuar kundër një vendimi apo politike të qeverisë

**Pati protesta civilësh kur qeveria miratoi ligjet që nuk pëlqeheshin nga populli.**

## koalicion

bashkimi i dy ose më shumë partive politike, zakonisht për të formuar një qeveri ose opozitë

**Pas zgjedhjeve, nuk doli asnjë parti fituese që të kishte shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, kështu që dy partitë me politika të ngjashme u bashkuan dhe krijuan një koalicion.**

## komision

një grup njerëzish me përgjegjësi zyrtare

**Zgjedhjet organizohen nga një komision i pavarur.**

## Kushtetuta

ligji suprem i Australisë të cilin duhet të respektojë qeveria

**Kushtetuta përcakton kompetencat legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.**

## monarki kushtetuese

një vend në të cilin mbreti ose mbretëresha janë kryetarë shteti, por që kompetencat e tyre janë të kufizuara nga Kushtetuta

**Kushtetuta jonë e krijoi Komunuelthin e Australisë si një monarki kushtetuese, duke pasur si kryetarë shteti Mbretin ose Mbretëreshën e Mbretërisë së Bashkuar.**

## gjykata

një vend në të cilin çështjet ligjore ndiqen nga një gjyqtar ose magjistrat

**Kur njerëzit shkelin ligjet ata mund të dalin para gjykatës.**

## seancë gjyqësore penale

dëgjimi i fakteve në gjykatë rreth një krimi të supozuar për të vendosur nëse një person është fajtor apo jo

**Pas seancës gjyqësore penale, grabitësi i bankës u dënua me burgim.**

## abuzim kibernetik

sjellja që përdor teknologjinë për të kërcënuar, frikësuar, ngacmuar seksualisht ose për të ofenduar dikë me qëllim lëndimin.

**Në Australi abuzimi kibernetik përbën shkelje të ligjit dhe duhet të denoncohet në polici dhe në shërbimet online, si platforma e medias sociale ku ndodhi abuzimi.**

## demokraci

qeverisja nga njerëzit nëpërmjet përfaqësuesve të tyre

*Grace ishte e lumtur të jetonte në një demokraci ku ajo mund të votonte për përfaqësuesin e saj në parlament.*

## dhuna në familje

sjellja apo kërcënimet që synojnë kontrollin e një partneri duke i shkaktuar frikë ose duke i cënuar sigurinë.

*Dhuna në familje nuk pranohet dhe përbën shkelje të ligjit. Në Australi dhuna në familje përbën shkelje të ligjit dhe duhet të denoncohet në polici.*

## trafiku i drogës

blerja ose mbajtja e drogës për ta shitur ilegalisht

*Jess u dënua me burg për trafik droge.*

## zgjedhje

një ngjarje në të cilën qytetarët zgjedhin një person për t'i përfaqësuar ata në parlament

*Shtetasit australianë mbi 18 vjeç duhet të votojnë në zgjedhje.*

## lista zgjedhore

listë personash që kanë të drejtë të votojnë në zgjedhje apo në referendum

*Kur Jan mbërriti në qendrën e votimit, zyrtari kërkoi në listën zgjedhore për emrin e tij.*

## Elektorati

Rrethet përbëhen nga votues që votojnë për të zgjedhur politikanë në Dhomën e Përfaqësuesve

*Elektoratet quhen rrethe, divisione ose vende zgjedhore.*

## barazi

status i njëjtë

*Australianët besojnë në barazinë mes të gjithë njerëzve.*

## zbatimi i ligjit

garantimi i zbatimit të ligjit nga njerëzit

*Policia zbaton ligjin dhe ruan rendin.*

## kompetencat zbatuese

fuqia dhe autoriteti për të administruar ligjet, një nga tre fuqitë nën Kushtetutën australiane

*Ministrat e qeverisë australiane dhe Guvernatori i Përgjithshëm kanë kompetenca zbatuese të administrojnë ligjet e dala nga Parlamenti australian.*

## mundësi të barabarta

të gjithëve, pavarësisht prejardhjes së tyre, u jepet një mundësi e barabartë për të arritur sukses në jetë

*Përkundrazi, ne besojmë në një shoqëri të drejtë, ku të gjithë meritojnë drejtësi.*

## federata

bashkimi i kolonive në një komb me kolonitë mbajnë një farë pushteti

*Në 1901, kolonitë u bashkuan në një federatë që u quajt Komonuelthi i Australisë.*

## Flota e Parë

një grup prej 11 anijesh të nisura nga Britania nën drejtimin e Kapitenit Arthur Philip për të krijuar një vendbanim më të dënuar në New South Wales

*Kapiteni Phillip drejtoi Flotën e Parë në Gjirit të Sidnejit në 26 janar 1788.*

## stema florale

lulja kombëtare

*Stema florale e Australisë është mimoza e artë.*

## martesë e detyruar

një martesë ku njëra ose të dyja çiftet nuk kishin një zgjedhje falas

*Ajo nuk kishte qenë kurrë e lumtur nga martesa e saj me detyrim dhe gjithmonë kishte dashur të largohej prej tij.*

### që nga ky moment e në vazhdim

nga sot dhe në të ardhmen

*Në ceremoninë e shtetësisë, ju premtori se do të jeni besnikë ndaj Australisë që nga kjo kohë e më pastaj.*

### ikonë

një imazh i mirënjohur

*Pallati i Operës është një ikonë e famshme e Sidnejit.*

### Indigjenët

Populli aborigjen dhe i Ishujve Torres States të Australisë

*Australianët indigjenë janë njerëzit e parë të këtij vendi.*

### integrimi

Procesi i përshtatjes së emigrantëve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë në zhvillim dhe kontributi i tyre ndaj saj

*Me kalimin e kohës, emigrantët përfitojnë nga integrimi i tyre në Australi dhe komunitetin lokal.*

### kompetencat juridike

fuqia dhe autoriteti për të interpretuar dhe zbatuar ligjet, një nga tre fuqitë në Kushtetutën australiane

*Gjykatat në Australi kanë kompetenca juridike për të interpretuar dhe zbatuar ligjin.*

### kompetencat legjislativë

fuqia dhe autoriteti për të nxjerrë dhe ndërruar ligjet, një nga tre fuqitë në Kushtetutën australiane

*Në bazë të kushtetutës, parlamenti ka fuqi legjislativë.*

### liritë (liria)

liria dhe pavarësia personale

*Në shoqërinë tonë demokratike, njerëzit kanë lirinë e fjalës, lirinë e të shprehurit, lirinë e besimit fetar si dhe atë të të mbledhurit. Ne i vlerësojmë këto liri.*

### magjistrati

një gjyqtar (drejtues) i një gjykate të ulët

*Magjistrati e shpalli grabitësin fajtor dhe e dënoi atë me burg.*

### miqësi

Të ndihmosh dhe të marrësh ndihmë nga të tjerët, sidomos në rast nevojë

*Kur makina ime u prish, në frymën e një miqësie shoferët e tjerë më ndihmuan ta shtyj atë.*

### himni kombëtar

kënga kombëtare

*Himni kombëtar australian është "Përparo e bukura Australi" ("Advance Australia Fair").*

### demokracia parlamentare

sistem qeverisës bazuar në zgjedhje sistematike nga shtetasit e përfaqësuesve të parlamentit

*Në një demokraci parlamentare, populli voton për përfaqësuesit e vetë.*

### parti politike

një grup njerëzish me pikëpamje të ngjashme për sa i përket qeverisjes së vendit

*Anëtarët e një partie politike takohen rregullisht, p.sh. për të diskutuar përmirësimet në transportin publik.*

### racizmi

paragjykimi, diskriminimi, ngacmimi seksual ose urrejtja i drejtohen dikujt për shkak të racës, ngjyrës, kombësisë ose origjinës etnike.

*Në Australi racizmi përbën shkelje të ligjit dhe duhet të denoncohet në polici. Ankesat mund të bëhen edhe tek Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut.*

### referendum

një votim nga të gjithë votuesit në një propozim për të ndryshuar Kushtetutën australiane

*Në referendumin e 1967-ës, populli votoi për të përfshirë indigjenët australianë në një regjistrim të përgjithshëm.*



### përfaqësues

një person që vepron ose flet për të tjerët

*Përfaqësuesi im bashkiak e pëlqeu idenë time dhe e shtroi atë në takimin e këshillit bashkiak.*

### respekt

tregoni konsideratë për dikë si person, ose për një vendim që ata kanë marrë

*Emily ishte e lumtur që familja e saj ishte në gjendje të respektonte vendimin e saj për t'u bërë budiste.*

### Rendi ligjor

të gjithë njerëzit, përfshirë qytetarët dhe qeveria, janë të detyruar nga ligji

*Të gjithë në Australi, përfshirë Kryeministrin, janë të bindur nga të gjitha ligjet australiane sipas rendit ligjor.*

### kutia e fshehtë e votimit

një sistem votimi, ku njerëzit votojnë fshehurazi, në mënyrë të tillë që askush mos të influencojë ose shtyjë sesi të votojnë

*Në kutinë e fshehtë, asnjë nuk ju shikon kur ju shkruani votën tuaj.*

### laik

e ndarë nga feja

*Në një shoqëri laike, nuk ka një fe zyrtare.*

### i pavarur

në gjendje të sigurojë nevojat tuaja personale, pa ndihmën e njerëzve të tjerë

*Të kesh një punë do të thoshte që ai ishte në gjendje të blinte ushqimin e vet dhe të paguante qiranë e tij. Ai ishte i pavarur.*

### Services Australia

një agjenci e qeverisë australiane që ofron një rang pagesash dhe shërbimesh shëndetësore, sociale dhe të mirëqenies përmes Medicare, Centrelink dhe Ndhimës për Fëmijët.

*Services Australia ofron ndihmë për pagesa përmes Centrelink dhe shërbime të tjera.*

### realizim

të ndërtosh, të krijosh, të fillosh

*Guvernatori Phillip ndërtoi koloninë e parë në New South Wales.*

### Shire (konte)

një zonë e një qeverie lokale

*Rrugët në qarkun tim janë shumë të sigurta.*

### sigurimi shoqëror

pensionet ose përfitimet që jepen nga qeveria në ndihmë të të papunëve, të paaftëve, të moshuarve si dhe njerëzve nevojtarë

*Kur Trang ngeli pa punë, ajo aplikoi për ndihmë sociale.*

### Zyra Tatimore e Australisë (ATO)

një agjenci e qeverisë australiane që menaxhon sistemet e taksave dhe të pensioneve që mbështesin dhe financojnë shërbimet për australianët.

*Çdo vit pjesa më e madhe e australianëve dorëzojnë një kthim takse tek Zyra Tatimore Australiane.*

### vlerat

parimet që ndihmojnë një person të vendosë se çfarë është e drejtë dhe e gabuar, dhe si të veprojnë në situata të ndryshme

*Australia ka një grup vlerash të përbashkëta, të cilat ne i quajmë vlera australiane.*

### vullnetar

një person që ofron kohën e tij ndaj një personi ose organizate, pa pagesë

*Raza është vullnetar që u mëson njerëzve anglisht në banesat e tyre.*



# Fundi i pjesës për të cilën do pyeteni